



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE TE PESHKIMIT**

**R R E G U L L O R E**

(Nr. 3, Date 20.6.2008)

**PER**

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NE RREGULLOREN NR 2 DATE 17.5.2007**  
**PER LICENSIMIN E PESHKIMIT DHE TE AKUAKULTURES**

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4, te Kushtetutes dhe te germave “ë” dhe “i” te nenit 32 te Ligjit nr. 7908 date 5.4.1995 “Për Peshkimin dhe Akuakulturën”, i ndryshuar, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerave miraton Rregulloren si me poshte:

**Neni 1**

Ne neni 2 shtohen pika 26 dhe 27 me kete permbajtje:

26 **Motofluge (ose motolance)** eshte cfaredo lloj mjeti lundrues i përfshirë në veprimtarinë e peshkimit, me gjatesi deri ne 15.00 metra qe ploteson kerkesat e neneve 38, 39 dhe 40 te Kodit Detar te Republikes se Shqiperise dhe qe ka si vend te dislokimit te mjetit njerin nga kater portet e peshkimit: Sarande, Vlore, Durres ose Shengjin.

27. **sanall, lunder, sul, take** dhe sinonime te ngjashme kuptohen cfaredo lloj mjeti lundrues i përfshirë në veprimtarinë e peshkimit, me gjatesi me te vogel se 15 metra, jashte kerkesave te pikes 26 te ketij neni dhe qe nuk ka domosdoshmerisht si vend te dislokimit te mjetit njerin nga kater portet e peshkimit: Sarande, Vlore, Durres ose Shengjin

**Neni 2**

Pikat 1, 2/a dhe 2/d te nenit 4 ndryshohen respektivisht si me poshte:

1. Subjekti qe kerkon te pajiset me licence per peshkimin detar me mjete lundruese me ose pa kuverte, si dhe me motofluge paraqet kerkesen per licence, sipas modelit KP1 qe ndodhet ne aneksin 1 te kesaj rregulloreje.

2 a) Vendimi i regjistrimit ne gjykate ose Dokumentin e Regjistrimit nga Qendra Kombetare te Regjistrimit (QKR) origjinal ose i noteruar.

2 d) hiqet.

**Neni 3**

Titulli, pikat 1, 2/a dhe 2/b te nenit 5 ndryshohen respektivisht si me poshte:

**Kerkesa per license peshkimi bregdetar me mjete lundruese me ose pa kuverte**

1. Subjekti qe kerkon te pajiset me licence per peshkimim detar me mjete lundruese me dhe pa kuverte, si sanall etj., paraqet kerkesen per licence, sipas modelit KP1 qe ndodhet ne aneksin 1 te kesaj rregulloreje.
- 2a) Vendimi i regjistrimit ne gjykate ose Dokumentin e Rregjistrimit nga Qendra Kombetare te Rregjistrimit (QKR) origjinal ose i noteruar
- 2b) Vertetim per depozitimim e kerkeses per perdorimin e mjetit lundrues nga subjekti i peshkimit (lunder, varke, sanall) te leshuar nga Policia Kufitare e rrethit ku do zhvillohet aktiviteti, origjinale ose e noteruar.

#### **Neni 4**

Pika 2/a e nenit 6 ndryshohet si me poshte:

- 2a) Vendimi i regjistrimit ne gjykate ose Dokumentin e Rregjistrimit nga Qendra Kombetare te Rregjistrimit (QKR), origjinal ose i noteruar

#### **Neni 5**

Pikat 2/a dhe 2/b te nenit 7 ndryshohen si me poshte:

- 2a) Vendimi i regjistrimit ne gjykate ose Dokumentin e Rregjistrimit nga Qendra Kombetare te Rregjistrimit (QKR) origjinal ose i noteruar
- 2b) ne se ka mjet lundrues, vertetim per depozitimim e kerkeses per perdorimin e mjetit lundrues nga subjekti i peshkimit (lunder, varke, sanall) te leshuar nga Policia Kufitare e rrethit ku do zhvillohet aktiviteti, origjinale ose e noteruar

#### **Neni 6**

1. Pika 2 e nenit 8, ndryshon si me poshte:

2. Subjekti aplikon njeherazi si per t'u pajisur me leje mjedisore ose autorizim mjedisor edhe per licence akuakulture. Per rastet e autorizimit mjedisor aplikimi per licence akuakulture behet prane Inspektorit te peshkimit te rrethit perkates. Ne kete rast Inspektori i peshkimit ploteson formularin FDP6 sipas aneksit 16/1

2. Ne nenin 8 shtohet pika 4 me kete permbajtje:

4. Ne kerkesen per akuakulture detare ose bregdetare percaktohen sakesisht koordinatat e vendosjes se impianteve ose te siperfaqes qe do te perdoret per kete qellim.

#### **Neni 7**

Neni 9 ndryshohet si me poshte:

#### **Kerkesa per licence peshkimi sportiv per mjetet lundruese shqiptare**

1. Kerkesa per t'u pajisur me licence per peshkim sportiv hartohet sipas formularit KPS qe ndodhet ne aneksin 10 te kesaj rregulloreje.
2. Kerkesa paraqitet nga shoqata te peshkataveve sportive ose personave te interesuar qe permbushin kriteret dhe kushte e permendura ne piken 3. Kerkesa nga Shoqatatat e peshkataveve sportive shoqerohet me dokumentat si me poshte:
  - a) Vendimin e regjistrimit ne gjykate ose Dokumentin e Rregjistrimit nga Qendra Kombetare te Rregjistrimit (QKR) te shoqates me objekt peshkimin sportiv. ( origjinal ose i noteruar)

- b) Vertetim per depozitimin e kerkeses per perdorimin e mjetit lundrues nga subjekti i peshkimit te leshuar nga Policia Kufitare e rrethit ku do zhvillohet aktiviteti, origjinale ose e noteruar. ( original ose i noteruar)
  - c) fotokopjen e noteruar te deshmise se aftesise te lundrimit per mjetet e vogla te Kapitenerise se Portit per mjetin apo mjetet lundruese te shoqates. Deshmia duhet te jete brenda afatit te vlefshmerise.
3. Kerkesa nga personat e interesuar per peshkim sportiv shoqerohet me dokumentat si me poshte:
- a. Vertetim per depozitimin e kerkeses per perdorimin e mjetit lundrues te leshuar nga Policia Kufitare e rrethit ku do zhvillohet aktiviteti, origjinale ose e noteruar, qe do te perdoret per peshkimin sportiv;
  - b. deshmime e kualifikimit perkates per drejtuesin e mjetit lundrues me te cilin kerkon te zhvilloje peshkimin sportiv, kur per drejtimin e mjetit lundrues kerkohet nje i tille;
  - c. zonen ne te cilen do te zhvilloje aktivitetin e peshkimit sportiv;
  - d. Deklarate nen pergjegjesi personale qe ne bordin e mjetit lundrues nuk ndodhen mjete peshkimi profesional pervec atyre te lejuara per peshkim sportiv.
  - e. Plotesimin e librit te anijes se peshkimit sportiv (aneksi 19 i rregullores) dhe dorezimi i tij prane inspektoriatit te peshkimit te zones, ne menyre periodike cdo jave.
4. Licenca e peshkimit sportiv, per shoqatata mund te autorizojte perdorimin e me shume se nje mjeti lundrues te lejuar ne ushtrimin e ketij aktiviteti. Ne kete rast, ne licence specifikohe :
- a) numri maksimal i mjeteve lundruese te autorizuar per zhvillimin e kesaj veprimtarie;
  - b) numri maksimal i diteve te peshkimit qe do te ushtroje secili mjet lundrues gjate nje viti;
  - c) numri maksimal i personave qe do te imbarkoje cdo mjet lundrues gjate ushtrimit te peshkimit sportiv.
  - d) listen e personave si dhe fotokopjen e dokumentave te tyre te identifikimit.
  - e) Drejtoria e Politikave te Peshkimit pais me nje kopje te legjislacionit per peshkimin sportiv cdo mjet lundrues te tyre qe eshte autorizuar te ushtroje kete veprimtari.
5. Ne licencen e peshkimit sportiv percaktohet zona ku do te zhvillohet kjo veprimtari
6. Inspektori i Peshkimit ploteson Formularin KPD6, sipas aneksit 17 te kesaj Rregulloreje.

## **Neni 8**

Pas nenit 9 shtohen nenet 9/1 dhe 9/2 me kete permbajtje:

### **Neni 9/1**

#### **Kerkesa per licence peshkimi sportiv per mjetet lundruese te huaja**

1. Kerkesa per t'u pajisur me licence per peshkim sportiv hartohet sipas formularit KPS qe ndodhet ne aneksin 10/1 te kesaj rregulloreje.

2. Kërkesa paraqitet pranë Inspektoratit të Peshkimit të rrethit ku kërkohej të zhvillohet aktiviteti nga përfaqësuesi ligjor i mjetit lundrues të huaj ose përdoruesi i tij dhe shoqërohet me dokumentat si më poshtë:
  - a) Dëshmia e pronësise ose e përdorimit të mjetit në shqip, origjinal ose i notuar;
  - b) Vertetim për depozitim të kërkesës për përdorimin e mjetit lundrues nga subjekti i peshkimit (lunder, varke, sanall) të leshuar nga Policia Kufitare e rrethit ku do zhvillohet aktiviteti, origjinale ose e notuar;
  - c) Fotokopjen e notuar të dëshmise së aftësisë të lundrimit për mjetet e vogla të Kapitenerisë së Portit të vendit të prejardhjes për mjetin apo mjetet lundruese;
  - d) Dokumentacioni i mjetit lundrues nga kapiteneria e portit të vendit të prejardhjes me karakteristikat e mjetit;
  - e) Lista e ekuipazhit ose personave në bord si dhe fotokopje të dokumentave të tyre të identifikimit;
  - f) Deklaratë nën përgjegjësi personale që në bordin e mjetit lundrues nuk ndodhen mjete peshkimi profesional përveç atyre të lejuara për peshkim sportiv;
  - g) Plotesimin e librit të anijes së peshkimit sportiv (aneksi 18 i rregullores) dhe dorezimi i tij pranë inspektoriatit të peshkimit të zonës në mënyrë periodike çdo javë;
3. Inspektori i Peshkimit plotëson Formularin KPD6, sipas aneksit 17 të kesaj Rregulloreje.

## **Neni 9/2**

### **Kushtet dhe kriteret në peshkimin sportiv**

1. Në peshkimin sportiv zbatohen kriteret dhe kushtet e mëposhteme:
  - a. ndalohet përdorimi i më shumë se pesë grepave (kallamave) për një peshkatar në ujërat detare dhe tre grepave (kallamave) në ujërat e tjera të ndryshme nga ujërat detare ;
  - b. ndalohet përdorimi i formës së peshkimit me burime drite, me përjashtim të një drite ose llampe dore për peshkimin nënujor;
  - c. ndalohet përdorimi fushnjerit për peshkim në të gjitha kategoritë ujore;
  - d. ndalohet mbajtja në mjetet lundruese të çdo lloji paisjeje e rrjetesh peshkimi, që përdoren në peshkimin profesional ose i rrjetave tërheqëse, me rrethim, dragave, rrjetave grumbulluese dhe njicave, palangareve për peshkimin e peshqëve shumë migrues;
  - e. ndalohet të peshkohen moluske, krustace si edhe lloje të tjera që ndalohen nga aktet nënligjore të nxjerrja nga ministria;
  - f. ndalohet të përdoren për peshkim si dhe të mbahen në bordin e mjetit lundrues, të substancave toksike, narkotike, ose geryese, të substancave që në rast se bashkohen me njëra tjetrën mund të shkaktojnë shpërthime si dhe të paisjeve që krijojnë shkarkime elektrike ose eksplozive;

- g. ndalohet te perdoren per peshkim dhe te mbahen ne bordin e mjetit lundrues çekiçe pneumatike ose paisje te tjera me goditje per grumbullimin e specieve ne shkembinj;
  - h. ndalohet te perdoren per peshkim dhe te mbahen ne bordin e mjetit lundrues paisje per peshkimin e koraleve;
  - i. ndalohet tregtimi i organizmave ujore te zene gjate peshkimit sportiv;
  - j. sasia qe peshkohet ne dite nga nje person te mos jete me e madhe se 3 (tre) kg peshk, pervec rastit kur pesha e nje ekzemplari te vetem e kalon kete kufi;
2. Ne peshkimin sportiv zbatohen te gjithë ndalimet e parashikuara per peshkimin profesional ne lidhje me zonat, sezonet e peshkimit, dimensionet e lejuara dhe kufizimet e grepave.
3. Ne peshkimin sportiv lejohet vetem perdorimi i grepave, pushkeve nenujore si dhe perdorimi i maskes dhe i tubit te frymemarrjes.

### **Neni 9**

Ne nenin 30 shtohet pika 1.1 me kete permbajtje :

- 1.1 Licensa behet automatikisht e pavlefshme ne rast se subjekti nuk ka paguar taksen vjetore te licenses brenda dates 31 maj te vitit ne vazhdim.

### **Neni 10**

Anekset 13, 14, 15 dhe 16 te Rregullores nr. 2 date 17.5.2007 “Per licensimin e peshkimit dhe te akuakultures” shfuqizohen.

### **Neni 11**

Kjo Rregullore hyn ne fuqi menjehere.

**MINISTRI**

**Lufter XHUVELI**

Roland Kristo  
Mimoza Cobani  
Fadil Gjuta  
Ardita Gjerazi  
Ilda Llaha

**KERKESE  
PER  
LIÇENCË TË PESHKIMIT SPORTIV (KPS/1)**

Përfaqësuesi ose përdoruesi i mjetit lundrues.....

me adresë.....

paraqet kërkesën për ushtrimin e peshkimit sportiv në zonën

.....

me formën e peshkimit.....

për zënien e llojeve.....

.....

me mjetin lundrues.....

për periudhën.....numër total ditësh.....

për një numur maksimal personash për mjet lundrues.....

date.....

Perfaqësuesi i mjetit lundrues të huaj

.....

.....



**MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE TE PESHKIMIT**  
**T I R A N Ë**  
**(FDP1)**

**Formulari i dokumentacionit te paraqitur**

Per tu plotësuar nga Inspektori

Subjekti .....

me adresë.....

ka paraqitur kërkesën për liçensë peshkimi me mjete lundruese me kuvertë

Bashkëngjitur ndodhet dokumentacioni si me poshte:

- Rregjistrimit nga Qendra Kombëtare te Rregjistrimit (QKR) original ose i noteruar.

- dëshmi e regjistrimit te anijes të Kapiteneria e Porteve (origjinale ose e noteruar):

- dëshmia e pronësisë \_\_\_\_\_

- dëshmia e flamurit \_\_\_\_\_

- çertifikatë e lundrimit lëshuar nga Regjistri Detar (origjinale ose e noteruar);

- miratimin e OMP për përdorimin e portit te peshkimit që kërkohet për ankorim te anijes (origjinale ose e noteruar); \_\_\_\_\_

Për tu plotësuar vetëm për rinovimet:  
statistikat e zënies \_\_\_\_\_

Komente \_\_\_\_\_

Inspektori

\_\_\_\_\_



**MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE TE PESHKIMIT**  
**T I R A N E**  
**(FDP2)**

**Formulari i dokumentacionit te paraqitur**

Per tu plotesuar nga Inspektori

Subjekti .....

me adrese.....

ka paraqitur kerkesen per license peshkimi bregdetar dhe te ujërave të brendshme me mjete lundruese pa kuvertë

Bashkengjitur ndodhet dokumentacioni si me poshte:

- Rregjistrimit nga Qendra Kombetare te Rregjistrimit (QKR) original ose i noteruar.

dokument te vlefshëm të regjistrimit te mjetit lundrues nga :

a) policia kufitare e rrethit perkates (origjinale ose e noteruar), \_\_\_\_\_

b) nga kapiteneria e porteve (origjinale ose e noteruar), \_\_\_\_\_

për ujëmbledhësit:

a) dokumenti i SHPU (origjinale ose e noteruar); \_\_\_\_\_

b) gent planin me karakteristikat \_\_\_\_\_

Për tu plotësuar vetëm për rinovimet:

statistikat e zënies \_\_\_\_\_

peshkëzimi me rasate për ujëmbledhësit \_\_\_\_\_

Komente \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Inspektori

\_\_\_\_\_





**MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE TE PESHKIMIT**  
**T I R A N E**  
**(FDP3)**

**Formulari i dokumentacionit te paraqitur**

Per tu plotesuar nga Inspektori

Subjekti .....

me adrese.....

ka paraqitur kerkesen per licensë peshkimi me mjete fikse ose stacionare si dhe ne grumbullimin e molusqeve në bregdet ose laguna

Bashkengjitur ndodhet dokumentacioni si me poshtë:

- Rregjistrimit nga Qendra Kombëtare te Rregjistrimit (QKR) origjinal ose i noteruar.

dokument të vlefshem të regjistrimit të mjetit lundrues nga : \_\_\_\_\_

a) policia kufitare e rrethit përkatës (origjinale ose e noteruar), \_\_\_\_\_

b) nga kapiteneria e porteve (origjinale ose e noteruar), \_\_\_\_\_

Per tu plotësuar vetëm për rinovimet:  
statistikat e zënies \_\_\_\_\_

Komente \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Inspektori  
\_\_\_\_\_



**MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE TE PESHKIMIT**  
**T I R A N E**  
**(FDP4)**

**Formulari i dokumentacionit te paraqitur**

Per tu plotesuar nga Inspektori

Subjekti .....

me adrese.....

ka paraqitur kerkesen per license peshkimi sportiv

Bashkëngjitur ndodhet dokumentacioni si me poshte:

- Rregjistrimit nga Qendra Kombëtare të Rregjistrimit (QKR) origjinal ose i noteruar. \_\_\_\_\_

dokument te vlefshem te regjistrimit te mjetit lundrues nga :

a) policia kufitare e rrethit perkates (origjinale ose e noteruar), \_\_\_\_\_

b) nga kapiteneria e porteve (origjinale ose e noteruar), \_\_\_\_\_

Për tu plotësuar vetëm për rinovimet:

statistikat e zënies \_\_\_\_\_

Komente \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Inspektori

\_\_\_\_\_



**MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE TE PESHKIMIT**  
**T I R A N E**  
**(FDP5)**

**Formulari i dokumentacionit te paraqitur**

Per tu plotesuar nga Inspektori

Subjekti i akuakultures .....

me adrese.....

ka paraqitur kerkesen per license akuakulture

Bashkengjitur ndodhet dokumentacioni si me poshte:

- Dokumentin e Rregjistrimit nga Qendra Kombetare te Rregjistrimit (QKR),  
(originale ose e noteruar) \_\_\_\_\_

- Lejen ose autorizimin mjedisor \_\_\_\_\_

- Gentplani i ekonomise apo kordinatat e sakta (sip. Ujore) \_\_\_\_\_

Per t'u plotesuar vetem per rinovimet:  
statistikat e zenies

Komente \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Inspektori

\_\_\_\_\_



**MINISTRIA E MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE**  
**DREJTORIA E POLITIKAVE TE PESHKIMIT**  
**T I R A N E**  
**(FDP6)**

**Formulari i dokumentacionit te paraqitur**

Per tu plotesuar nga Inspektori

Subjekti .....

me adrese.....

ka paraqitur kerkesen per license peshkimi sportiv

Bashkengjitur ndodhet dokumentacioni si me poshte:

- Deshmia e pronesise ose e perdorimit te mjetit ne shqip

( origjinal ose i noteruar)\_\_\_\_\_

- Vertetim nga Policia Kufitare e rrethit ku do zhvillohet aktiviteti,

(origjinale ose e noteruar).\_\_\_\_\_

- Dokumenti i deshmise se aftesise te lundrimit te Kapitenerise se Portit  
te vendit te prejardhjes per mjetin apo mjetet lundruese.\_\_\_\_\_

- Dokumentacioni i mjetit lundrues nga kapiteneria e portit te vendit te  
prejardhjes me karakteristikat e mjetit \_\_\_\_\_

- Lista e ekuipazhit ose personave ne bord si dhe fotokopje e  
dokumentave te tyre tedentifikimit. \_\_\_\_\_

- Deklarate mbi mjetet e peshkimit ne bord \_\_\_\_\_

Komente\_\_\_\_\_

Inspektori

\_\_\_\_\_



**REPUBLIC OF ALBANIA**  
**MINISTRY OF ENVIRONMENT, FORESTRY AND WATER ADMINISTRATION**  
**Fisheries Policies Directorate**

**Sportive Fishing Vessels Logbook**

No. of sheet _____	Year _____	Fishing Port _____						
Vessel name (1) _____	No. Fishing License _____							
Captain name (3) _____								
	DAY		MONTH		ORA		YEAR 20.....	FISHING ZONE (14)
Departure (4)						from		
Arrival (5)						in		
Landing (6)						in		

Nr	Name of fishing gear (8)	Mesh size (9)	Real fishing time (13)	Number of hauls (12)	No. of fishing gear	Largeness, Length or No. (10)	Height (meter)
1	Bottom trawls	xxxxxxx	xxxxxxxxxxx	xxxxxxxxx	xxxxxxxxx	(*)	xxxxxxxxxxxxx
2	Surrounding nets	xxxxxxx	xxxxxxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx	(**)	xxxxxxxxxxxxx
3	Gillnets and entangling nets	xxxxxxx	xxxxxxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxxxx	(***)	xxxxxxxxxxxxx
4	Hooks			xxxxxxx	(****)	(****)	xxxxxxxxxxxxx

(\*\*\*\*) No. hooks

No. of fishing gear (8)	Species caught		Fish weight		No. of big fish	Average weight of big fish	Total weight (15)	Discharge evaluation (16)
	Name	cod						
							<b>TOTAL KG</b>	

Under my Responsibility I declare the veracity of all the over mentioned data

SIGNATURE OF CAPTAIN OR OWNER \_\_\_\_\_



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TE UJERAVE**  
**Drejtoria e Politikave te Peshkimit**

**Libri i Anijes se Peshkimit Sportiv**

Nr. Fletes _____	Viti _____	Porti _____						
Emri i anijes (1) _____		Nr. Licenses se Peshkimit _____						
Emri i Kapitenit (3) _____								
	DITA		MUAJI		ORA		VITI 20.....	ZONA E PESHKIMIT (14)
Nisja (4)						nga		
Kthimi (5)						ne		
Zbarkimi (6)						ne		

Nr	Emri i paisjes se peshkimit (8)	Syze (9)	Oret efektive te peshkimit (13)	Numri i kalatave (12)	Numri i mjeteve rrjetave	Madhesia, Gjatesia ose nr (10)	Lartesia (metra)
1	Trata fundore koce	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx	(*)xxxxxxx	xxxxxxxxxxxxx
2	Rrjeta me rrethim	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx
3	Mrezha	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx	xxxxxxx
4	Grepa dhe linje grepash			xxxxxxx	(****)	(****)	xxxxxxxxxxxxx

(\*\*\*\*) Nr. i grepave

Nr. Paisjes (8)	Speciet e zena		Pesha e peshqeve	Numri i Peshqeve te medhenj	Pesha mesatare peshqeve te medhenj	Pesha totale (15)	Vleresim i hedhurinave (16)
	Emri	kodi					
<b>TOTALI KG</b>							

Deklaroj nen pergjegjesine time se te dhenat e sipershenuara jane te verteta

FIRMA E KAPITENIT OSE PRONARIT \_\_\_\_\_